



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI

### PROGRAMI I VEPRIMTARISË SË KLSH PËR VITIN 2013

#### A. OBJEKTIVAT PRIORITARË

Në Raportin e Progresit të Shqipërisë të Komisionit Evropian të muajit tetor 2012 nënvizohet se: “*Auditimi i jashtëm duhet të vijë në nivel me standardet e INTOSAI-t*”.

Për të arritur këtë, synimi strategjik i KLSH-së për vitet 2013-2016 është modernizimi i institucionit për të sjellë veprimtarinë e tij në përputhje të plotë me standardet e INTOSAI-t dhe me objektivat strategjike të Strategjisë së EUROSAI 2011-2017.

Për vitin 2013, objektivat prioritarë të institucionit dhe programi vjetor i veprimtarisë të tij sipas Departamenteve dhe Drejtorive, janë përsa më poshtë vijon:

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
1.	Objektivi themelor i KLSH-së është: <i>“Përdorimi efektiv dhe i dobishëm i fondeve publike, zhvillimi i mirëadministrimit financiar dhe kontrolli i zbatimit të ligjshmërisë në fushën ekonomike dhe financiare. Gjithashtu, të komunikojë dhe t’i japë informacion autoriteteve publike, si dhe publikut në përgjithësi, nëpërmjet publikimit të raporteve të paanshme”.</i> Në funksion të këtij objektivi themelor, për vitin 2013, KLSH parashikon drejtimet dhe masat për të përmbushur këto objektiva:	Në vazhdimësi	Të gjithë punonjësit e KLSH, me përjashtim të punëtorëve me klasa të profesioneve të ndryshme	Drejtorët e Përgjithshëm Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
2.	<p><i>Studimi dhe përvetësimi i parimeve dhe standardeve të auditimit të jashtëm të miratuara në kongreset e INTOSAI dhe EUROSAI, duke filluar nga Deklarata e Limës (viti 1977) dhe deri në kongresin e INTOSAI të zhvilluar në Johannesburg, Afrika e Jugut (viti 2010) dhe kongresin e EUROSAI të zhvilluar në Lisbonë, Portugali (viti 2011), përfshirë standardet ndërkombëtare të auditimit të miratuara nga IFAC.</i></p> <p>Zhvillimi i institucionit sipas drejtimeve kryesore të Planit Strategjik të EUROSAI 2011-2017, të cilat janë ndërtimi i kapaciteteve, standardet profesionale, shkëmbimi i njohurive dhe eksperiencave, menaxhimi në përputhje me parimet e qeverisjes së mirë dhe komunikimi efektiv. Në frymën e Deklaratës së Limës e Meksikës, si dhe të Rezolutës së Kombeve të Bashkuara të 22 dhjetorit 2011 për SAI-t, objektivat parësorë të KLSH-së gjatë vitit 2013 janë fuqizimi dhe rritja e cilësisë së auditimeve, thellimi i analizës së riskut dhe përmirësimi i qeverisjes, nëpërmjet shtimit të llogaridhënies dhe transparencës në administrimin publik.</p>	Në vazhdimësi	Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive Të gjithë punonjësit e KLSH, me përjashtim të punëtorëve me klasa të profesioneve të ndryshme	Drejtorët e Përgjithshëm
3.	<p><i>Sigurimi i bazës ligjore dhe rregullatore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira evropiane.</i></p> <p>Për këtë, do të ndërmerren të gjitha hapat e duhura për të bërë të mundur:</p> <p>a. Miratimin sa më parë të Ligjit të ri të KLSH-së, sipas variantit të dorëzuar në Kuvend në fund të muajit nëntor 2012, dhe më pas nxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të tij. Në Projektligjin e depozituar parashikohen përgjegjësi të reja në fushën e auditimit, saktësohen të drejtat dhe detyrimet e institucionit në bazë të standardeve INTOSAI, përcaktohet organizimi dhe struktura, statusi i personelit, procesi i certifikimit të deklaratave financiare të subjekteve të audituara, certifikimi i vetë audituesve të KLSH- së etj., si dhe detyrimi i KLSH-së për të dhënë një opinion për raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të shtetit dhe të sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm, gjë që kërkon kryerjen e një sërë aktiviteteve për rritjen e njohurive të stafit të auditimit për të mundur këtë objektiv.</p>	Gjatë vitit	Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive Kryeaudituesit, përgjegjësit e sektorëve, audituesit juristët dhe specialistët	Drejtorët e Përgjithshëm

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
	<p><b>b.</b> Hartimin nga KLSH të planit të vlerësimit të veprimtarisë të Sistemit të Auditimit të Brendshëm, në përputhje me standardet ndërkombëtare, inkurajimin e pavarësisë dhe përdorimin e punës së tij.</p> <p>Zhvillimi i metodologjive dhe aktiviteti strategjik i KLSH-së do të përqendrohet në vlerësimin, inkurajimin dhe mbështetjen e këtij Sistemi, si dhe në bashkëpunimin dhe përdorimin e punës së auditimit të brendshëm, kur ky i fundit plotëson standardet e tij profesionale. Rëndësia e zhvillimit të këtij sistemi është e trefishtë, pasi nëse ai është cilësor, ai ndikon në përmirësimin e menaxhimit të subjekteve të audituara, kursen drejtpërdrejt burimet e auditimit të KLSH, si dhe bëhet faktor në parandalimin e korrupsionit.</p> <p><b>c.</b> Miratimin brenda muajit janar 2013 të strukturës së re organizative, e cila do të jenë më fleksibële dhe e thjeshtë dhe ku do të përcaktohen qartë rolet dhe përgjegjësitë e çdo njësi, në mënyrë që të sigurohet përdorimi sa më i mirë i burimeve, të ulen kostot, të lehtësohen procedurat administrative, të sigurohet një komunikim i lirë midis stafit, si dhe një vendimarrje menaxheriale më eficiente.</p> <p><b>d.</b> Miratimin brenda 3/mujorit të parë të vitit 2013, të akteve të nevojshme ku të përcaktohen rregulla të qarta për sigurimin e një stafi kompetent, me vlera të larta profesionale dhe etike, si dhe të motivuar për plotësimin e misionit dhe objektivave strategjike të KLSH. Këto akte do të mundësojnë përmirësimin e sistemit të rekrutimit të stafit, zhvillimin e karrierës, trajnimin e vazhdueshëm, kryerjen e specializimeve dhe studimeve të ndryshme të nivelit pasuniversitar, vlerësimin e performancës individuale vjetore etj.</p> <p>Gjatë vitit 2013, do të fillojë puna për përgatitjen e një manuali të plotë për personelin, i cili do të përfshijë çështje që lidhen me përshkrimin e punës dhe përgjegjësitë, me raportimin, me politikën, procedurat e rekrutimit e të zhvillimit të karrierës, me postgraduimet e ndryshme universitare, me vlerësimin e performancës, promovimin, rregullat e sjelljes, rendin e brendshëm në punë dhe çështje të tjera bazë për menaxhimin e burimeve njerëzore.</p>	Gjatë vitit	Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive Kryeaudituesit, përgjegjësit e sektorëve, audituesit juristët dhe specialistët	Drejtorët e Përgjithshëm

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
4.	<p><b><i>Përmirësimi i kapaciteteve, cilësisë dhe produktivitetit të auditimit.</i></b></p> <p>Ndonëse në kushtet e një veprimtarie me burime të kufizuara, KLSH do të synojë përmirësimin e kapaciteteve, të cilësisë dhe produktivitetin e auditimeve, duke ju përmbytur standardeve profesionale ndërkombëtare INTOSAI dhe IFAC.</p> <p>Për këtë, gjatë vitit 2013 do të:</p> <p><b>a.</b> Bëhen përpjekje për të mënjeluar auditimet e tipit të inspektimit, duke kryer gjerësisht auditime të pajtueshmërisë, të cilat kanë potencialin për të pasur një impakt më të madh.</p> <p><b>b.</b> Auditohen një numër më i madh i ndërmarrjeve shtetërore në vartësi të ministrive apo dhe të qeverisjes lokale, si në fushën e energjetikës, ujësjellës kanalizimeve, ndërmarrjet e portit detar, hekurudhave, shërbimeve pyjore etj., të cilat konsiderohen zona me rrezik të lartë.</p> <p><b>c.</b> Zhvillohet metodologjia për auditimin financiar, përfshirë domosdoshmërisht metodën e vlerësimit të riskut, si dhe dhënien e opinioneve për deklaratat financiare të subjekteve të audituara. Zhvillimi i metodologjisë për auditimin financiar do të kryhet paralel me përgatitjen e Manualit mbi Auditimin e Pajtueshmërisë, mbi bazën e standardit ISSAI 4200.</p> <p><b>c.</b> Përbushet me profesionalizëm detyrimi ligjor i KLSH lidhur me auditimin e zbatimit të Ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, hyrë në fuqi 2 vitet e fundit, duke u fokusuar në përgjegjshmërinë menaxheriale të menaxherëve publikë. Në veprimtarinë e tij audituese, KLSH do të vlerësojë në tërësi ngritjen dhe funksionimin konformë kërkesave të ligjit të sistemit për menaxhimin e riskut. Madje, audituesit do të orientohen në mënyrë të veçantë tek metodat, teknikat dhe komponentët e vlerësimit të këtij sistemi.</p> <p><b>d.</b> Zhvillohet një metodologji në lidhje me raportimin e auditimit, duke synuar strukturimin e raporteve, duke futur formulimin e një përmbledhjeje ekzekutive, paraqitjen sa më selektive të gjetjeve, përdorimin e metodave dhe gjuhës grafike, si dhe formulimin më të mirë të rekomandimeve.</p>			

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
	<p>e. Përmirësojmë dukshëm formën dhe strukturën e raporteve për Kuvendin e Shqipërisë, duke synuar uljen e karakterit voluminoz të informacioneve dhe fokusimin te mesazhet. E njëjta gjë do të kihet parasysh për përgatitjen e njoftimeve për shtyp ose të përmbledhjeve të raporteve që kalojnë përmes mediave, duke i kushtuar rëndësi mesazheve sa më të lehta, të thjeshta dhe të drejtpërdrejta për publikun.</p> <p>f. Përgatitet një skemë e re për menaxhimin e cilësisë, duke përfshirë shqyrtimet në të ftohtë dhe në të nxehtë. Kjo skemë do të ketë ndikim të padiskutueshëm në rezultatet e auditimit dhe në kapacitetin institucional, si dhe do t'u japë një rol më të madh niveleve përkatëse menaxheriale të auditimit, duke u shoqëruar me përgjegjësitë e tyre për produktet e auditimit.</p> <p>Kjo skemë, do të përfshijë procesin e menaxhimit të cilësisë së auditimit në të gjitha fazat e auditimit, që nga programi i auditimit deri te ekzaminimi dhe raportimi. Ajo do të japë sigurinë e plotë të vendim-marrësve mbi besueshmërinë e raporteve të auditimit, duke u fokusuar në analizën e riskut.</p> <p>g. Forcohen kapacitetet audituese të stafit të KLSH-së, kryesisht nëpërmjet rritjes në mënyrë të vazhdueshme të njohurive individuale të punonjësve.</p> <p>Për këtë, do të vijojë të mbahet një normë e lartë trajnimi për stafin, të vendosur në vitin 2012, me 20 ditë trajnimi në vit për audituesit me eksperience dhe 25 ditë trajnimi në vit për të rinjtë.</p> <p>Gjithashtu, do të hartohet një strategji sektoriale për trajnimin e burimeve njerëzore me të gjithë elementët e saj, ku të përfshihet rritja e profesionalizmit të stafit përmes studimeve pasuniversitare në nivel masteri apo doktorature, ndjekjes së studimeve universitare në degë të dyta, përmirësimit të nivelit dhe zgjerimit të audituesve që njohin gjuhën e huaj (kryesisht anglisht) dhe shfrytëzimin e materialeve dhe studimeve në gjuhë të huaj.</p>	Gjatë vitit	<p>Drejtorët e Departamenteve të Auditimit dhe Kryeaudituesit Drejtori i Departamentit Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe TI Drejtori Juridik dhe Sigurimit të Cilësisë Drejtore e Burimeve Njerëzore Zëdhënësi</p>	Drejtorët e Përgjithshëm

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
5.	<p><b><i>Përmirësimi i cilësisë dhe shtimi i numrit të auditimeve të performancës.</i></b></p> <p><b>a.</b> Në përputhje me burimet e krijuara, përmirësimi i cilësisë së auditimeve të performancës dhe shtimi i numrit të tyre për të kryer 10 auditime në vitin 2013, përbën një nga sfidat madhore të KLSH-së. Krijimi i Departamentit të Auditimit të Performancës me 16 auditues, në përbërje të të cilit u inkuadruan audituesit më me përvojë dhe ambiciozë në KLSH dhe auditues të rinj me perspektivë, e mundëson këtë objektiv.</p> <p><b>b.</b> Mbështetur në rezultatet përfundimtare të auditimeve të performancës, KLSH do të këshillojë dhe ndihmojë drejtuesit dhe personelin e enteve të audituara për përmirësimin e proceseve të punës dhe të cilësisë së shërbimeve publike, duke përdorur burimet me ekonomikitet, efektivitet dhe eficiencë.</p> <p><b>c.</b> Për të kompletuar njohuritë e stafit në lidhje me kryerjen e auditimeve të performancës, në vijim të vizitave studimore dhe trajnimeve për këtë lloj auditimi të kryera gjatë vitit 2012 në SAI-t homologe të Polonisë, Sllovenisë dhe Turqisë, për vitin 2013 do të realizohen programe të tjera të veçanta trajnimi, në këto vende si dhe pranë SAI-ve homologe në Kroaci dhe Kosovë, duke ju përmbajtur objektivit për ditë/trajnimi për çdo auditues gjatë vitit 2013.</p>	Janar 2013 dhe gjatë	Drejtori i Departamentit të Auditimit të Performancës dhe Kryeaudituesi	Drejtori i Përgjithshëm
6.	<p><b><i>Përdorimi i Teknologjisë së Informacionit në auditim dhe përgatitja teorike e praktike për zhvillimin e auditimeve të TI.</i></b></p> <p><b>a.</b> Përdorimi i mjeteve të TI në auditim është objektiv kryesor i institucionit. <i>Për këtë vit, nga 4 departamentet e auditimit (pa performancën) do të kryhet nga një auditim duke përdorur programin IDEA, në subjektet që kanë bazë të dhënash.</i></p> <p><b>b.</b> Intensifikimi i komunikimit të brendshëm elektronik është një drejtim tjetër i këtij objekti. Brenda vitit, KLSH do të zgjerojë përdorimin e rrjeteve të brendshëm të komunikimit elektronik, për të lehtësuar komunikimin dhe koston e tij. Për këtë, me fondin e siguruar për investime në vitin 2013 në fushën e TI, gjithsej 15.5 milionë lekë, është programuar të shtrihet rrjeti kompjuterik tek çdo përdorues; të futen disa shërbime të reja; të zëvendësohen një pjesë e pajisjeve të amortizuara nëpërmjet blerjes.</p>	Gjatë gjithë vitit	Drejtorët e Departamenteve të Auditimit Drejtori i Departamentit të Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe TI, Përgjegjësi i Sektorit dhe specialistët e TI	Drejtorët e Përgjithshëm

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
	<p>c. Ndryshimet e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve publike të dixhitalizuara dhe në komunikim, si në prokurimet elektronike, në tatime, dogana dhe Thesarin e Shtetit, kërkojnë qasje të re të auditimit nga ana e KLSH-së për të mbuluar me auditim këto veprimtari.</p> <p>Aktualisht, burimet njerëzore në KLSH janë tejet të pamjaftueshme për të zhvilluar auditimin e këtyre sistemeve të TI. Duke filluar nga viti 2013 do të synohet bërja e ndryshimeve në përdorimin, zhvillimin dhe konsolidimin e TI, gjë që do të reflektohet në rritjen e kapaciteteve të auditimit të TI. Njëkohësisht, do të punohet për hartimin e metodologjisë për auditimin e TI, përzgjedhjen e një stafi kompetent dhe trajnimin e vazhdueshëm të tij në këtë fushë.</p>			
7.	<p><b><i>Forcimi i rolit antikorrupsion për sigurimin e mirëqeverisjes.</i></b></p> <p>a. KLSH do të sinergjizojë veprimtarinë e tij me Strategjinë Ndërsektoriale të Parandalimit, Luftës kundër Korrupsionit dhe Qeverisjes Transparente 2008-2013 të qeverisë Berisha, duke bashkëpunuar më ngushtë me të gjithë institucionet që e luftojnë korrupsionin dhe marrë angazhime të përbashkëta.</p> <p>Bazuar në rekomandimet e INTOSAI dhe standardin ISSAI 1240, ku përcaktohet roli i SAI-t në luftën kundër korrupsionit, KLSH-ja ka filluar të orientohet më mirë duke vënë theksin në analizën e rreziqeve dhe dobësive të sistemeve që auditojmë dhe duke synuar uljen e këtyre rreziqeve dhe parandalimin efektiv të korrupsionit. Ndikimi dhe këmbëngulja për krijimin e një mjedisi parandalues kundër mashtrimit financiar dhe korrupsionit, përfshirë forcimin e sistemeve të menaxhimit financiar, vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe identifikimin dhe korrigjimin e mangësive, do të jenë objektiva të veprimtarisë audituese të KLSH.</p> <p>b. Objektivi tjetër i rëndësishëm i KLSH-së është përcaktimi i drejtë, me paanshmëri dhe bazuar në legjislacionin në fuqi të masave të propozuara ndaj administratoreve publike të kapur në shkelje ligjore dhe/ose abuzim me pronën publike, ose të atyre që kanë konflikte interesash, si dhe rritja e kërkesës për zbatimin e tyre.</p>	Gjatë gjithë vitit	Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive	Drejtorët e Përgjithshëm

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
	<p>Për këtë, KLSH do të kërkojë zbatimin e Urdhërit të Kryeministrit Berisha nr. 70, datë 18/4/2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, të Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në KM, në institucionet në varësi të Kryeministrit a të Ministrave”.</p> <p>Gjithashtu, KLSH do të ndjek zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit të nënshkuara me ILKPD-në dhe me Autoritetin e Konkurrencës, për të punuar së bashku në rastet kur gjatë auditimit do konstatohen apo evidentohet praktika abuzive në administrimin publik në kontratat e prokurimeve, të ankandeve, koncensioneve etj.</p> <p>c. Intensifikimi i bashkëpunimit me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm është parësor për KLSH-në, për të rritur cilësinë e kallëzimeve të tij dhe shtuar vëmëndjen e prokurorisë ndaj denoncimeve të institucionit. Kohët e fundit, Prokuroria ka treguar vëmëndje të shtuar dhe ka nisur hetime bazuar në kallëzimet e KLSH.</p> <p>Gjatë 2013-ës, KLSH do të zbatojë plotësisht marrëveshjen me Zyrën e Prokurorit të Përgjithshëm, përfshirë tryeza pune dhe trajnime të përbashkëta auditues-prokurorë, për një trajnim sa më efikas të materialeve referuese të dërguara nga KLSH.</p>			
8.	<p><b><i>Zhvillimi i komunikimit dhe bashkëpunimi me aktorët brenda vendit.</i></b></p> <p>Për këtë, gjatë vitit 2013, KLSH do të:</p> <p><b>a.</b> Hartojë dhe zbatojë një strategji komunikimi, duke vënë në qendër të saj marrëdhëniet me publikun dhe me Kuvendin e Shqipërisë.</p> <p><b>b.</b> Konsolidojë bashkëpunimin me <i>Kuvendin</i> si partneri kryesor i KLSH-së, dhe ku raporton lidhur me përgjegjshmërinë qeveritare të përdorimit të burimeve publike. Përveç informacioneve të paraqitur në Komisionin e Ekonomisë dhe të Financave, KLSH i paraqet Kuvendit edhe raportin për zbatimin e Buxhetit të Shtetit dhe veprimtarinë vjetore të tij.</p>			



Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
	<p>Gjithashtu, fuqizimi i bashkëpunimit me <i>Qeverinë</i>, si përgjegjësi kryesor për hartimin dhe ekzekutimin e Buxhetit të Shtetit mbetet objektiv primar.</p> <p>Në këtë kuadër, fokusi kryesor i punës së KLSH-së takohet me funksionet e qeverisë dhe veçanërisht të <i>Ministritë se Financave</i>, si institucioni përgjegjës në qeveri për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe për sigurimin e kuadrit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.</p> <p>Bashkëpunimi me qeverinë, në veçanti me Auditimin e Brendshëm është sanksionuar në marrëveshjen e veçantë ku janë përcaktuar rolet dhe përgjegjësitë e palëve në këtë partneritet, bazuar dhe në Standardin ISSAI 9150 të INTOSAI. Ky proces i ndërsjellë i shërben edhe rritjes së besimit të publikut në institucionin e KLSH, si dhe monitorimit të tij nga publiku, ashtu dhe rritjes së besimit të publikut ndaj qeverisjes.</p> <p>Krahas Kuvendit dhe Qeverisë, KLSH ka për objektiv konsolidimin e bashkëpunimit me Agjencitë e zbatimit të ligjit, si <i>Prokuroria e Shtetit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, Departamenti Antikorrupsion në Këshillin e Ministrave, Autoriteti i Konkurrencës, Agjencia e Prokurimeve Publike, Departamenti i Administratës Publike</i> etj., sidomos në fushën e shkëmbimit të informacionit, me qëllim rritjen e efektivitetit të luftës kundër korrupsionit dhe mashtrimit financiar.</p> <p>Në këtë kuadër, gjatë vitit 2012 ky bashkëpunim është sanksionuar me nënshkrimin e disa marrëveshjeve dhe në vijim pritet të nënshkruhen edhe marrëveshje të tjera.</p> <p>Shoqatat profesionale kombëtare vlerësohen nga KLSH si një partner i rëndësishëm, veçanërisht <i>Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) dhe Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit</i>, me të cilat KLSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe do të zhvillojë veprimtari me interes të ndërsjellë, kryesisht në zërthim dhe zbatim të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit IFAC.</p> <p>c. Shtojë praninë me informacione dhe mesazhe në median vizive dhe të shkruar të vendit; mundësimin e editorialeve në mediat kryesore të shkruara lidhur me</p>	Gjatë gjithë vitit	Drejtorët e Departamenteve dhe Drejtorive Zëdhënësi	Drejtorët e Përgjithshëm

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
	<p>problematikën e auditimit publik në vend; praninë e ekspertizës së shoqërisë civile dhe kontributin e saj në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve të përbashkëta; rritjen e bashkëpunimit dhe partneritetit me organizatat e shoqërisë civile, sidomos me OJF si Organizata Transparency Internacional në Shqipëri, Lëvizja “Alternativa Civile”, Qendra për Transparencë dhe Informim të Lirë, Instituti i Studimeve Bashkëkohore, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Lëvizja Evropiane Shqipëri dhe Instituti “G&amp;G Group”, me të cilat ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për luftën kundër korrupsionit, në kryerjen e vrojtimeve dhe analizave të përbashkëta për nivelin e korrupsionit dhe shkallës së transparencës në administratën publike.</p> <p><b>d.</b> Publikojë në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile dhe median, fletëpalosje, buletine, broshura dhe libra për rritjen e luftës kundër korrupsionit dhe të transparencës së administrimit publik; gjithashtu do të realizojë tryeza pune, dëgjime publike, konferenca dhe simpoziume për rritjen e transparencës dhe shkallës së përgjegjshmërisë së administratës publike në menaxhimin e fondeve publike me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.</p> <p><b>e.</b> KLSH do të publikojë revistën katërmujore “Auditimi Publik” që doli në 3 numra gjatë vitit 2012.</p> <p>Gjithashtu, KLSH do të organizojë konferencën e përvitshme shkencore mbi Auditimin e Jashtëm Publik në Shqipëri.</p>			
9.	<p><b>Zhvillimi dhe konsolidimi i bashkëpunimit me aktorët jashtë vendit,</b></p> <p><b>a.</b> Krahas vijimit dhe konsolidimit të mëtejshëm të bashkëpunimit të frutshëm me INTOSAI, EUROSAI dhe me institucione homologe të SAI-ve si SAI polak, slloven, turk, kroat dhe me Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës, me të cilat janë nënshkruar edhe marrëveshje bashkëpunimi për fusha me interes të ndërsjelltë, përfshirë trajnimet e punonjësve të KLSH pranë SAI-ve të përparuara evropiane; një bashkëpunim i ndërsjelltë parashikohet të zhvillohet me IFAC (Organizata Ndërkombëtare e Kontabilistëve) dhe Gjykatën Evropiane të Llogarive, nëpërmjet kontakteve të vazhdueshme, shkëmbimit të informacionit</p>			

Nr. Re.	OBJEKTIVAT PRIORITARË TË KLSH	AFATI	PERSONAT E NGARKUAR ME DETYRËN	DREJTUESI QË E NDJEK
	<p>dhe përvojave, si dhe kryerjes së veprimtarive të përbashkëta, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në forcimin e kapacitetit institucional.</p> <p><b>b.</b> Gjatë vitit 2013, KLSH synon nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me SAI-t e Bavarisë, Austrisë, Britanisë së Madhe dhe Norvegjisë, si dhe intensifikimin e bashkëpunimit me rrjetin e SAI-ve të Evropës Juglindore, veçanërisht SAI-t e vendeve fqinje.</p> <p>KLSH nëpërmjet marrëveshjeve do të realizojë trajnime të vazhdueshme të audituesve të tij në SAI-t moderne partnere me të.</p> <p><b>c.</b> <i>SIGMA</i> përbën një nga partnerët tanë kryesorë dhe ndër më të rëndësishmit jo vetëm për kontributin e Programit gjatë viteve të fundit në monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetit të KLSH, por edhe për ndihmësen thelbësore që ka dhënë gjatë gjysmës së dytë të vitit 2012 me trajnime në fushën e auditimit të performancës, të auditimit financiar, të pajtueshmërisë dhe të teknologjisë së informacionit, si dhe për bashkëpunimin frytdhënës në përgatitjen e Strategjisë së Zhvillimit të KLSH-së për periudhën 2013-2016.</p> <p>KLSH do të vazhdojë bashkëpunimin intensiv me <i>SIGMA</i> përgjatë gjithë vitit 2013 dhe më tej. <i>SIGMA</i> është padyshim një garanci e zhvillimit cilësor të kapaciteteve audituese të KLSH-së.</p> <p><b>d.</b> KLSH do të realizojë trajnime, seminare dhe botime të përbashkëta në fushën e auditimit me <i>Zyrën e Audituesit të Përgjithshëm të Kosovës</i>, duke synuar intensifikimin e bashkëpunimit me këtë paqrtner shumë të rëndësishëm.</p> <p><b>e.</b> <i>DG-Budget dhe në tërësi Delegacioni i BE-së në Shqipëri</i> janë partnerë shumë të rëndësishëm dhe themelorë të KLSH-së. Krahas kontributit të vyer të <i>DG-Budget</i> për përgatitjen e draft-amendimeve të ligjit organik të KLSH-së në nëntor 2012, duke dërguar dhe një ekspert të tij me mjaft përvojë, Delegacioni i BE në Shqipëri ka miratuar projektin e binjakëzimit të propozuar nga KLSH në kuadër të fondeve IPA 2013 (fillon nga implementimi në vitin 2014) dhe po tregon një vëmendje të shtuar ndaj rolit dhe kontributit që institucioni mund të luajë në miradministrimin e fondeve publike dhe përmirësimin e qeverisjes në Shqipëri.</p>	Gjatë gjithë vitit	<p>Drejtori Kërkimit Shkencor, Zhvillimit dhe TI</p> <p>Drejtori i Drejtorisë së Marrëhënieve me Jashtë</p> <p>Drejtorët e Departamenteve të Auditimit</p>	Drejtorët e Përgjithshëm

## **B. MENAXHIMI FINANCIAR DHE KONTROLLI**

<b>Nr. Re.</b>	<b>OBJEKTIVAT PËR T’U REALIZUAR MASAT DHE VEPRIMET</b>	<b>AFATI</b>	<b>PRITSHMËRIA</b>	<b>PERSONAT E NGARKUAR</b>
1.	<p>Në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të rishikohet përgjegjshmëria menaxheriale dhe linja e raportimit dhe rastet e delegimit të të drejtave dhe detyrave. Po kështu dhe i kordinatorit të riskut.</p> <p>Përditësimi i strategjisë së menaxhimit të menaxhimit të riskut të KLSH-së dhe ndjekja e zbatimit të tij, si dhe miratimi i gjurmës së auditimit për prokurimet me vlerë të vogël dhe të lartë. Do të krijohet sektori i Analizës së Riskut.</p>	Brenda 3/mujorit parë e në vijimësi	<p>Zbatimi i kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Gjithashtu, zbatimi i kërkesave të udhëzimit MF nr. 92, datë 29/12/2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.</p> <p>Minimizimi i ngjarjeve apo situatave që kanë efekt të dëmshëm për plotësimin e objektivave të KLSH.</p>	<p>Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues Drejtori Drejtorisë Ekonomike</p>
2.	<p>Përgatitja e deklaratës dhe raportit mbi cilësinë e kontrollit të brendshëm për vitin 2012, si dhe të pyetësorit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të cilat pasi të shqyrtohen në Grupin e Menaxhimit strategjik të KLSH, t’i paraqiten Kryetarit të KLSH-së dhe Nëpunësit të Parë Autorizues pranë MF-ve.</p>	Brënda datës 1 mars 2013	<p>Zbatimi i detyrimit ligjor të përcaktuar në ligjin nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, neni 18.</p>	<p>Nëpunësi Autorizues Nëpunësi Zbatues</p>
3.	<p>Vlerësimi i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të sistemeve, të strukturave, të vendimeve, të procedurave të auditimeve, si dhe vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.</p>	Çdo 4/mujor dhe vjetor	<p>Vlerësimi i gjëndjes, evidentimi i mangësive e identifikimi i risqeve që kërcënojnë arritjen e objektivave, me synim zvogëlimi apo shmangia e tyre.</p> <p>Dhënia e vlerësimit objektiv dhe sigurisë së arsyeshme të funksionimit të sistemit.</p>	<p>Njësia e Auditimit të Brendshëm</p>

### **C. RAPORTIMET NË KUVEND DHE NË KOMISIONET PRANË KUVENDIT**

<i>Nr. Re.</i>	<i>TEMATIKA</i>		<i>Periudha e paraqitjes sipas 3-mujorëve</i>			
			<i>I</i>	<i>II</i>	<i>III</i>	<i>IV</i>
1.	Përgatitja e raportit “Mbi veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2012”. Paraqitja e tij në Kuvend (sipas kërkesës), brenda datës 1 mars 2013.	Detyrim kushtetues dhe ligjor	Po	-	-	-
2.	Përgatitja e raportit “Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012” dhe dhënia e mendimeve për raportin e Këshillit të Ministrave për shpenzimet e vitit të kaluar financiar (viti 2012), para se të miratohet nga Kuvendi. Paraqitja e tij në Kuvend brenda datës 20 shtator 2013.	Detyrim kushtetues dhe ligjor	-	-	Po	-
3.	Përgatitja dhe paraqitja në Komisionet pranë Kuvendit, kryesisht në Komisionin e Ekonomisë dhe Financës të informacioneve për rezultatet përfundimtare të auditimeve sa herë që kërkohen prej tyre.	Sipas kërkesës	Po	Po	Po	Po

## **D. PLANIFIKIMI STRATEGJIK I AUDITIMEVE – DEPARTAMENTET E AKTIVITETIT KRYESOR**

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
<b>I.</b>	<b>DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QËNDROR, ADMINISTRATËS SË LARTË PUBLIKE, MENAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM</b>						
<b>a.</b>	<i>Auditim në Ministrinë dhe Institucionet për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012, vlerësimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe mbikëqyrjen e organizimit dhe funksionimit të auditimit të brendshëm, në zbatim të programit të veçantë që hartohet për këtë qëllim nga ky Departament në bashkëpunim me Departamentet e tjerë të Auditimit, duke filluar nga muaji janar 2012, në:</i>						
<b>1.</b>	Ministrinë e Financave, Tiranë dhe njësitë e vartësisë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Drejtorinë e Buxhetit</li> <li>- Drejtorinë e Thesarit</li> <li>- Drejtorinë e Borxhit</li> <li>- Drejtorinë e Kontabilitetit</li> <li>- Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit</li> <li>- Njësinë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, Tiranë</li> </ul>	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	- Është detyrim kushtetues dhe ligjor dhe ushtrohet në funksion të përgatitjes së raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012. - Ka administruar një buxhet si institucion për vitin 2012, mbi 7.4 miliardë lekë. - Vlerësimi i veprimtarisë së NJQHMFK është detyrim ligjor dhe pjesë përbërëse e raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012. - Po kështu dhe auditimi i NJQHAB (mbikëqyrja e funksionimit të auditimit të brendshëm). - Periudha e auditimit, nga 1/1/2012 deri më 31/12/2012.	Po	-	-	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditivit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
2.	Banka e Shqipërisë	Përputhshmëri (ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Auditimi është detyrim kushtetues dhe ligjor dhe ushtrohet në funksion të përgatitjes së raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012.</li> <li>- Si institucion ka administruar një buxhet vjetor rreth 5 miliardë lekë dhe realizon të ardhura nga aktiviteti që kryen mbi 8 miliard lekë.</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2012 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	Po	-	-	-
3.	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit dhe argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet mbi 2.3 miliardë lekë për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/7/2011 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	Po	-	-	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditivit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
4.	Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>vjetor rreth 39 miliard lekë.</i></li> <li>- Periudha që do auditohet 1/10/2011 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	Po	-	-	-
5.	Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga dhe shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime. - Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>-Ka administruar një buxhet <i>mbi 42 miliardë lekë</i> për vitin 2012.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar, kontrollit dhe auditimit të brendshëm.</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/7/2011 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	-	Po	-	-



Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
6.	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet mbi 2.3 miliardë lekë për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2012 deri më 31/12/2012</li> </ul>	-	Po	-	-
7.	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet mbi 2.4 miliardë lekë për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/4/2012 deri më 30/6/2013</li> </ul>	-	-	-	Po

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
8.	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime. - Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet mbi 6.8 miliardë lekë për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/4/2012 deri më 30/6/2013</li> </ul>	-	-	-	Po
9.	Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Tiranë dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Është detyrim ligjor dhe ushtrohet në funksion të përgatitjes së raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012</li> <li>- Llogaritja e përfitimeve sipas skemave.</li> <li>- Bashkëpunimi me INSTAT, Organet Tatimore dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës për uljen e informalitetit të tregut të punës</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet vjetor mbi 85 miliardë lekë.</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2012 deri më 31/12/2012</li> </ul>	-	Po	-	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
10.	Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë dhe njësitë e varësisë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Është detyrim ligjor dhe ushtrohet në funksion të përgatitjes së raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012</li> <li>- Puna e bërë dhe çështjet e dala në lidhje me përdorimin e fondeve të miratuara, sipas strukturës së shpenzimeve.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet vjetor mbi 27 miliardë lekë.</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2012 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	Po	-	-	-
11.	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe njësitë e varësisë (Reparti nr. 100)	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime. - Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet mbi 11.8 miliardë lekë për vitin 2012.</li> <li>- Për DPPSH periudha auditimit 1/4/2011 deri më 31/12/2012, kurse për Repartin nr. 100 disa vjeçare.</li> </ul>	-	Po	-	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
12.	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime. - Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>mbi 90 milionë lekë</i> për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/10/2010 deri më 30/6/2013</li> </ul>	-	-	Po	-
13.	Drejtoria e Përgjithshme e Pyjeve	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>mbi 713 milionë lekë</i> për vitin 2012</li> <li>- Periudha auditimit 1/1/2011 deri 30/6/2013</li> </ul>	-	-	Po	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
14.	Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit të Shtetit	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>mbi 167 milionë lekë</i> për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/4/2010 deri më 30/6/2013</li> </ul>	-	-	-	Po
15.	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës – Kanalizimeve, Tiranë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime. - Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm, si dhe vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>mbi 10 miliardë lekë</i> për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/10/2011 deri më 31/12/2012</li> </ul>	-	Po	-	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
16.	Universiteti i Tiranës	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit dhe argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm</li> <li>-Ka administruar një buxhet <i>mbi 3 miliardë lekë</i> për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2010 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	Po	-	-	-
17.	Universiteti Politeknik, Tiranë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit dhe argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>mbi 750 milionë lekë</i> për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2010 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	-	-	Po	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
18.	Universiteti Bujqësor, Kamëz Tiranë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit dhe argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>mbi 750 milionë lekë</i> për vitin 2012.</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2010 deri më 31/12/2012.</li> </ul>	-	-	Po	-
19.	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm</li> <li>- Ka administruar një buxhet <i>rreth 1.4 miliard lekë</i> për vitin 2012</li> <li>- Periudha që do auditohet 1/1/2009 deri më 31/12/2012</li> </ul>	-	Po	-	-

Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
20.	Shërbimi Social Shtetëror, Tiranë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime. Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si dhe vlerësimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.</li> <li>- Ka administruar një buxhet vjetor për mbrojtjen sociale mbi 19.4 miliardë lekë.</li> <li>- Periudha e auditimit 1/6/2010 deri më 31/12/2012</li> </ul>	Po	-	-	-
21.	Spitali Universitar i Sëmundjeve të Mushkërive “Shefqet Ndroqi”, Tiranë	Përputhshmërie (ligjshmëri dhe rregullshmëri financiare)	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Hartimi dhe zbatimi i buxhetit, ndryshimet e bëra gjatë vitit e argumentimi ligjor i tyre.</li> <li>- Ligjshmëria e përdorimit të fondeve për paga e shpërblime, për shpenzime operative dhe për investime.</li> <li>- Prokurimi i fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.</li> <li>- Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave jashtë limitit.</li> <li>- Vlerësimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm</li> <li>- Ka administruar një buxhet mbi 500 milionë lekë për vitin 2012</li> <li>- Periudha e auditimit 1/1/2009-31/12/2012.</li> </ul>	-	Po	-	-



Nr. Re.	DEPARTAMENTI, SUBJEKTI DHE TEMATIKA	Lloji i Auditimit	Arsyet e Auditimit	Koha e auditimit ndarë në 3/mujorë			
				I	II	III	IV
